



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 100 prot.

Kamëz, më 26.07 .2024

V E N D I M
Nr. 77 .Datë 26/07 2024
M B I

“DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 2, DATË 22/01/2024 "PËR PËRCAKTIMIN E DISA KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSSET PËR TO NË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.07.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.54 Datë 19.07.2024 në mbështetje të pikës 1, gërma "a" dhe pika 2 të nenit 113 të Kushtetutës; Nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 29, pikat 3 dhe 4, nenit 33, pika 1, nenit 54, shkronja "k" dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"; Nenit 5, nenit 6 shkronja "b", nenit 10, pika 3, nenit 13, pika 1, shkronja "a", nenit 14, pika 4, nenit 20, shkronja "dh" dhe nenit 37, pika 1, të Ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative"; Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; Ligjit nr. 89, datë 22.12.2022, "Për Policinë Bashkiake"; Nenit 5 pika 1, nenit 10, nenit 12, nenit 23, nenit 29 dhe nenit 38, të Ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar; Nenit 11, nenit 12, nenit 27, nenit 35, nenit 37 dhe nenit 38, të Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave"; Nenit 3 pika 32, nenit 18 pika 3, nenit 20 pika 1 dhe nenit 31, pika 12, të Ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar; Vendimit nr. 99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", i ndryshuar; Nenit 4, 8 pika 4, nenit 12, nenit 18 pika 1.2, nenit 29 pika 1, nenit 32 pika 1, shkronja "a", "b" dhe "s" dhe nenit 34, të Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", të ndryshuar; Nenit 4, pika 1, shkronja "c" të Ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, si dhe pika 7.7 shkronjat "m" dhe "n" dhe pika 7.8 shkronja "f" të Shtojcës 1 bashkëlidhur këtij ligji; Udhëzimin nr. 5, datë 26.11.2010 "Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis"; Nenit 66, nenit 73 dhe nenit 76, të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Vendimit nr. 1096, date 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike"; Udhëzimit nr. 230, datë 20.03.2013, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e funksioneve dhe detyrave specifike të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

dhe neni 34 i "Rregullores së administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit", miratuar me Vendimin nr. 447, datë 16.06.2010 të Këshillit të Ministrave; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e Vendimit nr. 2, datë 22/01/2024, "Për përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Kamëz" të bëhen shtesat, si më poshtë, vijon:

a. Në Kreun II "Për Kundërvajtjet Administrative", konkretisht, Neni 8 "Për Kundërvajtjet Administrative në fushën e sigurisë", të shtohen:

- Gërma "I", "Mosrespektimi e sinjalistikës vertikale për mjetet e tonazhit të rëndë".
- Gërma "II", "Qarkullimi i mjeteve të tonazhit të rëndë mbi 5 ton, në rrugët e brendshme të Bashkisë Kamëz, të pa pajisura me Autorizim të kushtëzuar".
- Gërma "m", "Mosrespektimi i itinerarit të përcaktuar në Autorizimin e kushtëzuar, për lëvizjen e mjeteve të tonazhit të rëndë mbi 5 ton, në rrugët e brendshme të Bashkisë Kamëz".

b. Në Kreun III "Sanksionet administrative dhe menyra e caktimit te tyre", konkretisht Neni 16

"Masa e gjobës për kundërvajtjet administrative kundër rregullave të bashkëjetesës shoqërore", pika 2, shtohen përkatësisht kundërvajtjet administrative të cituara në pikën 1 të këtij vendimi.

2. Reflektohen këto ndryshime në VKB nr. 137, date 22.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz" e ndryshuar.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve ligjore të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

